

Pas tërheqjes së forcave serbe, rreth orës 18:00, Albani u kthye në shtëpi. Në oborr e ka gjetur gjyshin e vdekur. I kishte plagët nga plumbat në kokë dhe gjoks. Tahirin e kanë varrosur në varrezat në mëhallën e tij. Atje prehet edhe sot.

**Burimet:** deklarata E.H, FDH-13663; *Llausha Village Fired Upon by Serbs Overnight*, pasqyra e lajmeve, KIC, 21.07.1998, FDH-29372.

## Mexhit (Brahim) Kurti

(5.09.1935, shqiptar nga Mitrovica/Kosovska Mitrovica, i papunë, tre fëmijë)

Mexhiti me origjinë ishte nga fshati Çabër/Çabar [Zubin Potok]. Deri në vitin 1990, punonte si postier në Mitrovicë/Kosovska Mitrovica. Atëherë, pushteti serb e pushoi nga puna si edhe shqiptarët e tjerë. Jetonte në bashkësi familjare me bashkëshorten Mevlyzen, djemtë Ibrahimin dhe Blerimin dhe vajzën Shpresen. Vuante nga diabeti.

Motra e Mexhitit, Kada, jetonte në fshatin Kuçicë/Kučica. Në afërsi të fshatit, në muajin korrik të vitit 1998, zhvilloheshin luftimet mes forcave të UÇK-së dhe atyre serbe. Mexhiti ishte i brengosur për motrën dhe, më **20.07.1998**, nga mesdita, u nis për një vizitë tek ajo. Shkoi me autobus deri te Klina e Epërme/Gornja Klina, ndërkaq nga ky fshat e vazhdoi rrugën më këmbë. Në hyrje të **Kuçicës/Kučica**, në afërsi të urës, e ka dëgjuar urdhrin „stoj“ (ndalu), në gjuhën serbe. Mexhiti u ndal. I ka vërejtur pjesëtarët e forcave serbe në kodrën e afërt. Një minutë më vonë dhe pa kurrfarë paralajmërimi, ata hapën zjarr ndaj tij dhe e plagosën në këmbët. Mexhiti gjendej i shtrirë në atë vend për gjysmë ore, për sa kohë nuk u larguan forcat serbe. Atëherë, erdhi një banor i fshatit dhe e barti Mexhitin në shtëpinë e vet. Ia lidhi plagët. Më pas, banorët e çuan Mexhitin në spitalin e UÇK-së në Likoc/Likovac. Atje u kurua për pesë javë rresht. Pastaj, djemtë e kthyen në shtëpi. Mexhiti ka ndërruar jetë më 9.09.1998 nga pasojat e plagosjes. Po atë ditë, familjarët e kanë varrosur në varrezat e fshatit të Shupkocit/Šupkovac.

**Burimet:** deklarata S.M, FDH-37121; fotografi, FDH-20698.

## Azize (Hajzer Mala) Hajdini

(12.01.1954, shqiptare nga Klina e Poshtme/Donja Klina, komuna e Skënderajt/Srbica, amvise, pesë fëmijë)

Në muajin korrik të vitit 1998, Azizja dhe bashkëshorti i saj Fazliu i kanë strehuar fëmijët e vet te motra e Fazliut në Prekazin e Epërm/Gornje Prekaze, ndërkaq ata u kthyen në fshat. Në mëngjes, më **25.07.1998**, rreth orës 8:00, forcat serbe kanë shtënë mbi shtëpitë e banorëve. Pasdite, Azizja dhe Fazliu morën vendim që të provonin të depërtonin deri te Prekazi i Epërm/Gornje Prekaze. E morën një rrugë dytësore. Kur arritën te vendi i quajtur *Lug i Gjatë/Duga staza [Klinë e Poshtme/Donja Klina]*, pjesëtarët e forcave serbe kanë shtënë drejt tyre. Azizja dhe Fazliu tentuan që të iknin me vrap, por plumbat e qëlluan Azizen në qafë, gjoks dhe këmbë. Pas pak, ndërroi jetë. Kur pushuan të shtënat, Fazliu e ka bartur dhe fshehur trupin e bashkëshortes në shkurre dhe, më pas, u largua nga vendi i ngjarjes. Më vonë, kur situata u qetësua, ai u kthye me traktor dhe e mori trupin e bashkëshortes. Familjarët e kanë varrosur Azizen ditën e nesërme në varrezat e fshatit të saj të lindjes së Rezallës/Rezala, ku prehet edhe sot.

**Burimet:** deklarata E.H, FDH-17261; *Serb Forces Embark on Large-Scale Attack in Drenica*, pasqyra e lajmeve, KIC, 27.07.1998, FDH-29378.

## Shiqeri (Azem) Ahmeti

(1942, shqiptar nga Radisheva/Radiševo, komuna e Skënderajt/Srbica, udhëheqës ndërrese, shtatë fëmijë)

## Haxhi (Imer) Ahmeti

(1942, shqiptar nga Radisheva/Radiševo, komuna e Skënderajt/Srbica, arsimtar i gjeografisë, shtatë fëmijë)

## Alban (Muhamet) Ahmeti

(12.12.1981, shqiptar nga Radisheva/Radiševo, komuna e Skënderajt/Srbica, nxënës i shkollës së mesme të informatikës, pjesëtar i UÇK-së)

Në muajin qershor të vitit 1998, forcat serbe i kanë zënë pozicionet përreth Radishevës/Radiševo. Gratë dhe fëmijët i braktisën shtëpitë, ndërkaq banorët e moshuar dhe ushtarët e UÇK-së mbetën në fshat. Kur herët në mëngjes, më **25.07.1998**,